



Mësimdhënia dhe të nxënit e shkencave natyrore në klasat 1-5

Qëllimi i programit:

Ky modul është dizajnuar me mbështjeten e projektit 'Ngritja e Kapaciteteve në Sektorin e Arsimit Fillor në Kosovë - CDBE me qëllim të zhvillimit të metodologjisë bashkëkohore në të nxënit e koncepteve shkencore për fëmijët e klasave 1 deri 5 tek mwsimdhwnwsit e nivelit fillor tw arsimit.

Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve:

Ky program i dedikohet zhvillimit dhe aftësimin profesional te mësimdhënësve në nivelin e shkollave fillore (ISCED 1), klasat 1-5 me fokus të veçantë në njohuritë e shkencave natyrore. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për mësimdhënësit e ardhshëm të këtij niveli. Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim do të jetë 15-25.

Rezultatet e programit:

Në fund të këtij program mësimdhënësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë strategji, metoda dhe teknika ndërvepruese të mësimdhënies dhe të nxënit, që mundësojnë ndërtimin dhe krijimin e njohurive te nxënësit, formimin e shprehive, zhvillimin e kompetencave në përputhje me Kornizën e Kurrikulës dhe rezultatet e të nxënit në fushën kurrikulare Shkencat natyrore.
- Përdorin veprimtari të shumëllojshme dhe të efektshme për shprehitë e procesit në shkencat e natyrës: vëzhgimin, krahasimin, klasifikimin dhe analizën, të cilat ndihmojnë nxënësit në ndërtimin e koncepteve për dukuritë natyrore dhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme me karakter vëzhgues dhe hulumtues.
- Përshtasin mësimdhënien e tyre nevojave dhe mundësive të nxënësve, duke përdorur metoda ndërvepruese dhe të nxënit aktiv, të cilat nxisin të menduarin kritik dhe formojnë nxënës të pavarur,
- Zhvillojnë imagjinatën dhe krijimtarinë e nxënësve përmes përdorimit të organizuesve grafikë dhe mjeteve të tjera pamore,
- Përdorin mjete të ndryshme konkretizuese me qëllim të aftësimin të nxënësve për hulumtim të informacioneve të ndryshme në Internet, të nxënit e koncepteve shkencore përmes situatave simuluese ose reale dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësit në këtë lëndë.